



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

### EKSTRAKT

**nga procesverbali i mbajtur më 02 gusht 2019, në mbledhjen e XIV-të (katërmëdhjetë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10:45.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu – Podvorica, Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Mefail Rama, Bashkim Syla, ndërsa mungoi Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe, Faik Muçiqi, Drejtor i Drjetorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Enver Ajeti nga Policia e Kosovës, Bekim Karaxhija përfaqësues nga OSBE, Tunde Molnar Bokrosh përfaqësuese e KFOR – LMT, si dhe Xhavit Fejza dhe Nevzat Qorrolli nga UNMIK.

### Rendi i ditës

**znj. Albina Avdiu**, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të dhe shtoi, nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

*Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar.*

### 1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 02.07.2019

*Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 02 korrik 2019.*

### 2. Informatë rreth vizitave të anëtarëve të Komitetit në lagjet – vendbanimet ku jetojnë familje të Komunitetit jo shumicë.

**znj. Albina Avdiu**, Kryesuese e Komitetit, e paraqiti një informatë rreth vizitës së anëtarëve të Komitetit në lagjet ku jetojnë dhe banojnë familje të komunitetit RAE, ndër të tjera theksoi, si anëtar të Komitetit më 22 dhe 23 korrik 2019, kemi vizituar dy lagje në qytet ku jetojnë familje të Komunitetit jo shumicë, Lagja “Ali Ajeti” dhe Lagja “Xhafer Meta”.

Më 22 korrik 2019 kemi vizituar banorët që jetojnë në lagjen "Ali Ajeti" ku kemi dëgjuar nga afër nevojat, problemet dhe kërkesat e tyre ku kryesisht është infrastruktura (kanalizim, ujësjellës), pastaj si kërkesë ka qenë edhe hapja e një qendre për mësimdhënie për fëmijët e komuniteteve, mandej janë paraqitë kërkesa edhe për strehim.

Më 23 korrik kemi vizituar lagjen "Xhafer Meta" ku kërkesat dhe nevojat pothuajse kanë qenë të ngjashme, me theks është paraqitur një problem me kanalizim ku në disa raste ndodh të depërton brenda në shtëpitë e tyre. Po ashtu kemi vizituar edhe familjen 17 anëtarësh, familja Behluli e cila ka kërkuar ndërtimin e një shtëpie, veshmbathje, gjëra ushqimore si dhe rregullimin e kanalizimit afër tyre që vazhdimisht ju shkakton probleme. Pra kryesisht këto kanë qenë kërkesat e banorëve të këtyre dy lagjeve, dhe ndoshta arsyeja pse e kemi ftuar sot këtu z.Faik Muçiqin Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, ka qenë që të na njoftoj më në detaje se deri ku ka shkuar projekti i ndërtimit të kanalizimit, dhe për projekte tjera në infrastrukturë nga të cilat përfshihen edhe ato dy lagje, pasi që kërkesat e tyre kanë qenë kryesisht në këtë drejtim.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, para se Drejtori të merr fjalën dëshiroj të jap disa sqarime edhe pse në vizitën që i është bërë banorëve të komunitetit RAE në lagjen "Xhafer Meta" nuk kam mund të jem prezent për shkak se kam qenë në pushime, për çka edhe kërkoj falje.

Sa i përket komuniteteve jo shumicë që jetojnë në lagjen "Ali Ajeti", unë kam biseduar me Drejtorin e DSHPMSH, ka qenë në pyetje ndërrimi i një gypi të ujësjellësit dhe kam marrë premtim që ajo çështje do të rregullohet sepse është me rëndësi kjo, kurse për infrastrukturën tjetër (kanalizim më të mirë, parqe, hapësira tjera sportive etj.) të kërkuar natyrisht se paraqitet nevojë e vazhdueshme dhe vazhdimisht bëhen investime, por uji i pijes është diçka tjetër. Sa i përket qendrës rinore që unë e kam paraparë në afërsi të atyre banorëve, kam biseduar edhe me Kryetarin e Komunës dhe me organet tjera relevante, disponimi është por nuk mund të themi se do të bëhet shpejt ngase paraqiten probleme rreth pronës të cilat nganjëherë dalin të jenë shoqërore por që ligjërisht janë disa procedura në mënyrë që ti jepet në shfrytëzim dikujt, siç është rasti komunitetit jo shumicë. Kjo ka qenë ide e imja sepse siç e them gjithëherë jemi komunitet që bashkëjetojmë, unë madje e kem edhe projektin të gatshëm për qendrën në fjalë, por e përsëris që problem kryesor paraqitet prona, pastaj edhe mirëmbajtja e asaj qendre.

Gjithashtu problem paraqitet edhe punësimi, dhe jo vetëm për komunitetin jo shumicë por për të gjithë pothuajse, por ndoshta në të ardhmen do të ketë një përkushtim më të madh për një zhvillim më të madh ekonomik, për rritje të punësimit e të ngjashme që ndikojnë në përmirësimin e jetesës së të gjithë qytetarëve, kurse në infrastrukturë siç jemi në dijeni të gjithë janë bërë investime të mëdha dhe pothuajse është në përfundim e sipër, natyrisht ujësjellësi është Ndërmarrje Publike regjionale dhe nuk ka të bëjë me Komunën por me një angazhim të përbashkët me Komunën natyrisht se ata intervenojnë aty ku paraqiten nevojat.

Ajo që dëshiroj ta cekë është se tani është edhe koha e rishikimit të buxhetit, e që nëse nuk gabojmë është muaji shtator, unë kam bërë apel përfaqësuesve të lagjeve që ti paraqesin në formë të shkruar dhe zyrtare të gjitha kërkesat e tyre të cilat përmes protokollit dërgohen në Drejtorinë përkatëse, pra për një gjë të tillë ende ka kohë të bëhet dhe sërish bëjë thirrje të paraqiten kërkesa e të gjithëve pa përjashtim, duke përfshirë edhe nga ne që jemi këtu dhe që jemi në dijeni për ndonjë problem të caktuar.

**z.Faik Muçiqi**, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, sa i përket problemit të ujësjellësit në lagjen "Ali Ajeti" jam i njoftuar më parë dhe ai projekt është në procedurë të prokurimit dhe do të përfundojë në këtë vit, kurse kërkesat tjera që u paraqiten janë më të vogla, me përjashtim të kanalizimit në lagjen "Xhafer Meta" për të cilin shpresojmë se në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim ta zgjidhim edhe atë, pra kemi të bëjmë me ndryshimin komplet të rrjetit të kanalizimit

sepse në atë pjesë pavarësisht intervenimeve të shpeshta që bëhen, fatkeqësisht paraqiten probleme për shkak të hedhjes së madhe të mbeturinave, mos mirëmbajtjes nga ana e një pjesë të banorëve atje, pastaj mungesë e kapacitetit të tij andaj edhe ndodh të paraqiten probleme,. Pavarësisht kësaj shpresojmë që në këtë vit ta ndërrojmë të paktën një segment të kanalizimit në atë pjesë. Në atë Lagje jemi duke përfunduar projektin e ndriçimit publik, zgjerim të rrjeteve në infrastrukturë dhe pastrimi dhe zgjerim i prrockës që paraqitet problem nganjëherë për shkak të reshjeve të mëdha e që deri tani ka qenë problem me disa uzurpime por që tani janë tejkaluar.

Në rr. "Vëllezërit Frashëri" kemi një kanalizim të stërngarkuar dhe të vjetër ku jemi duke punuar, por në të njëjtën kohë është duke punuar edhe KEDS në ndërrimin e shtyllave dhe përmirësimit të infrastrukturës së rrjetit andaj edhe po hasim në probleme të ndryshme.

Kërkesat që u paraqiten nuk mendoj se kanë ndonjë kosto të madhe për Komunën, por është mirë që gjithherë të paraqiten në formë të shkruar dhe në mënyrë zyrtare. Vlen të theksohet se Komuna ka të kontraktuara kompani të cilat mirëmbajnë kanalizimet qoftë fekale qoftë atmosferike, pastaj rrjetin e ujësjellësit, rrjetin e ndriçimit publik etj, që ne i kemi marrë përsipër për riparime, mirëmbajtje apo edhe në raste të caktuara ndërrim të gypave, kështu që ne çdo herë jemi të gatshëm por vetëm kërkesat të bëhen me shënime të sakta dhe sigurisht që do të intervenohet ngase po të shikohen fotografitë apo drejtpërdrejt se çka gjendjen në ato puseta vërtetë është e tmerrshme, andaj do të ishte mirë t'iu bëhej thirrje dhe banorëve që të jenë më të kujdesshëm se çfarë hedhin në kanalizime, pastaj në rrethinë e Lagjes "Xhafer Meta" pothuajse çdo 10 ditë ose dy javë hiqen (vidhen) kapakët metalik të pusetave, për çka kam kërkuar edhe nga Policia të merren me këtë çështje. Pra të adresohen kërkesat, duke përfshirë edhe ato të anëtarëve të këtij Komiteti, e që mund të dalim bashkërisht edhe në vendin ta shikojmë nga afër gjendjen në terren, qoftë edhe probleme familjare që mund të jenë sa i përket infrastrukturës.

**znj.Doruntina Hasani**, theksoi, dua të shtoj rreth vizitës, në Lagjen "Ali Ajeti" ku jetojnë një numër i madh i banorëve të Komunitetit jo shumicë, përfaqësuesi i lagjes z.Xhafer Ademi, e potencoi se jemi në mesin e 5 Komunave që kemi përfituar nga 200,000.00€ nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, mirëpo ai shprehi frikën nga dështimi i projektit – humbja e mjeteve ngase sipas tij mjetet buxhetore lëshohen vetëm për një projekt mbi 50,000.00€. Po ashtu i njëjti pati vërejtje sa i përket qendrës për punësi ku sipas tij prej që ka ardh drejtori i ri i Drejtorisë përkatëse ne si komunitet nuk kemi asnjë informatë rreth punësimit. Andaj mendoj se duhet të kemi parasysh edhe vërejtjet që bëhen nga qytetarë të komuniteteve jo shumicë.

**znj.Albina Avdiu**, Kryesuese e Komitetit, theksoi, sa i përket vërejtjes rreth qendrës për punësim, besoj se shumë shpejt do të marrë informata dhe të shohim se ku qëndron problemi, ndërsa rreth buxhetit të ndarë prej 200,000.00€ për ndonjë projekt të Komuniteteve jo shumicë, nuk ndonjë informatë më të saktë, por do të bëjë përpjekje të marrë ndonjë informatë nga Deputetët e Kuvendit të Kosovës që janë nga radhët e Komuniteteve jo shumicë, mirëpo kjo ndoshta mund të varet edhe nga rënia e Qeverisë, por të shohim.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, gjatë vizitës në lagjen "Xhafer Meta" breng kryesore e atyre banorëve ka qenë kanalizimi. Drejtori parafolës shumë mirë e shtjelloj atë çështje por më intereson se për cilën rrugë apo pjesë konkretisht bëhet fjalë. Sipas atyre banorëve, shumica e kërkesave janë bërë me shkrim në Komunën e Podujevës.

Çështje tjetër që vlen të theksohet gjatë vizitës tonë, ishte familja Behluli të cilën e vizituam, gjendja e asaj familjeje ishte e mjerueshme, andaj mendoj se breng kryesore për ne të gjithë është që të paktën asaj familje t'i sigurohen gjërat elementare të jetesës, (ushqim, veshmbathje, etj), ngase vërtetë gjendja e tyre ish e mjerueshme, ndërsa për çështje tjera rreth infrastrukturës besoj se drejtori i sqaroj të gjitha dhe nuk kam çfarë të shtoj.

**z.Faik Muçiqi**, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, sa i përket premtimit të Qeverisë për ndarjen e 200,000.00€ për ndonjë projekt i cili prek Komunitetin jo shumicë, pikërisht kemi të bëjmë me projektin e kanalizimit për të cilin inxhinierët e kanë paraparë se duhet të ndërrohet komplet ai rrjet, janë bërë paramasat dhe paralogaritë dhe presim se shumë shpejt të fillojmë me punime, përkatësisht të hiqet nga rr.”Skenderbeu” për shkak se çdo rritje e nivelit nga reshjet, ajo lagje qëndron më ultë gjeografikisht, ku pastaj ujërat kthehen nëpër oborre, andaj ne do ta ndryshojmë komplet sistemin ku do kthejmë kanalizimin në anën e kundërt. Pra ky projekt është bërë nga inxhinierët dhe a do të financohet nga Ministria nuk e di, nëse jo, do të financohet nga Komuna e Podujevës me buxhetin e vitit të ardhshëm.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, sa i përket asaj që e ceku znj.Dornuntina Hasani që ka të bëjë me zyrën e punësimit, për çka në fakt z.Xhafer Ademi paska bërë vërejtje, zyra në fjalë vërtetë është zyre e veçantë e cila është në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Çështje e punësimit vërtetë është paksa problematike sepse mund të ndodh që njerëzit lajmërohen për shkak të ndihmave sociale dhe numri i saktë nuk mund të jetë korrekt ndoshta dhe numër evoluon. Zyra e punësimit nuk ka të bëjë me Komunë, por është në kuadër të MPMS, por normal duhet pajtohemi të gjithë se punësimi është problemi kryesor në Kosovë.

Zyra e punësimit dhe Qendra për Punë Sociale - QPS e cila është në kudër të Komunës – DSHMS-së, kanë ndërlidhmëni mes vete sepse, përkatësisht ata që nuk kanë mundësi të punësohen dhe i plotësojnë të gjitha kriteret për të marrë ndihmën sociale, çështje kjo e cila te Komunitetet jo shumicë është shumë e shprehur, atëherë për të mos i'u ndaluar ajo ndihmë sociale, ata persona lajmërohen në Zyrën për punësim, dhe mu për këtë është numri më i madh i Komuniteteve jo shumicë që marrin ndihmë sociale, por si Komunë nuk mund të ndërhyjë në punësim ngase është çështje dhe kompetencë e nivelit qendrorë kjo.

Sa i përket asaj që u përmend e që ka të bëjë me gjendjen e Familjes Behluli, t’ju them sinqerisht se Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS e ka këtë kategori, dhe po të analizojmë ndoshta është mirë të hiqet kjo skema e çështjes sociale, e them këtë ngase tani po del se po ndërlidhen gjërat, është shefi i sektorit për çështje sociale për ndihma, (që po quhen ndihma elementare për jetë), dhe është QPS, e cila duhet ta ketë përkujdesjen për ushqim, për veshmbathje etj, por megjithatë meqë QPS ndoshta nuk po mund të zgjidh të gjitha çështjet sociale, atëherë DSHMS e ka këtë sektor shtesë, dhe publikisht ju them se në shumë vende nuk ekziston kjo që DSHMS të merret me çështje skamnore sepse nuk ka ndonjë buxhet enkas kjo Drejtori për këtë çështje, por megjithatë ekziston ky sektor dhe i trajton mirë rastet në fjalë, me atë buxhete që ka, mirëpo buxhetin dhe obligimin kryesor e ka Ministria e Punë dhe Mirëqenies Sociale.

Pavarësisht kësaj Komuna ndihmon këto raste qoftë me mjete buxhetore – subvencion, pako ushqimore, veshmbathje etj, por këto ndihma janë simbolike për shkak të buxhetit të vogël për këtë kategori, andaj si shtet dhe si shoqëri ndoshta duhet të ndërhyhet në këtë aspekt.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, pajtohem me parafolësin sepse ashtu edhe mendoj se është. Para rreth 4 mbledhjeve, zyrtari përkatës i DSHMS na ka dhënë informata rreth kësaj çështje dhe buxhetit që ka Komuna për këtë kategori. Ku e ceka rastin në fjalën tima paraprake, nuk e pata qëllimin tek Komuna, por qëllimi ishte që të bëjmë diçka ne të gjithë pa përjashtime, qoftë përmes shoqatave, donatorëve etj, që të paktën ajo familje të ndihmohet sepse vërtetë ish në gjendje shumë të rëndë.

Sa i përket projektit që u cek, është mirë që ne si Komunë të kryejmë obligimet tona ngase shembull, në rast se ato mjete buxhete prej 200,000.00€ të ndara nga Ministria për ndonjë projekt në Komunën e Podujevës, për shkak të mos kryerjes së obligimeve tona, mbetet të pashfrytëzuara atëherë vërtetë është gabim.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, ne jemi në dijeni se numri i qytetarëve, në përgjithësi nuk i kanë kushtet e mira jetësore është më i madh sa ne mendojmë. Në shumë raste ku ka qenë në pyetje strehimi, shembull janë paraparë ndërtimi i 10 shtëpive por falë donatorëve të ndryshëm që janë paraqitë ai numër është rritur në 15, andaj interesi më i madh i Komunës është të gjejë donatorë të ndryshëm qoftë individual qoftë përmes shoqatave, të cilat i falënderoj përzemërsisht ngase në të shumtën e rasteve ato paraqiten vullnetarisht në Komunë dhe ofrojnë ndihma të ndryshe për skamnorët.

**z.Faik Muçiqi**, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, sa i përket atyre 200,000.00€, është shumë vetëm e premtuar deri tani nuk ka kurrfarë marrëveshje apo diçka më shumë në këtë aspekt, po shpresojmë dhe jemi të gatshëm që çfarëdo që kërkohet ne si Komunë do të ndërmarrim veprime konkrete.

**znj.Albina Avdiu**, Kryesuese e Komitetit, theksoi, i falënderoj parafolësit për diskutimet dhe sqarimet e nevojshme rreth temave të ngritura. Nëse nuk të tjerë që dëshirojnë fjalën, kalojmë në pikën të ndryshme.

### 3. Të ndryshme

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, meqë jemi në procesin e buxhetimit, bëjë apel nga të gjithë që të gjitha kërkesat dhe nevojat e paraqitura nga familjet e Komunitetit jo shumicë, të adresohen zyrtarisht në formë të shkruar dhe t'i drejtohen shërbimeve përkatëse. Pra për çfarëdo kërkesë të paraqiten në Komunë, pastaj organet përkatëse komunale i shqyrtojnë, analizojnë dhe aty ku paraqitet nevoja e domosdoshme, varësisht mundësive buxhetore, sigurisht se intervenohet apo edhe hyjnë në planifikime buxhetore për vitin 2020.

**z.Mefail Rama**, theksoi, në vitin e kaluar në lagjen rr.“Ali Ajeti” ku jetojnë një numër jo i vogël i familjeve të Komunitetit RAE, është formuar një ekip nga ky komunitet të cilët kanë biseduar dhe kanë vënë në letër të gjitha kërkesat e tyre të cilat pastaj i janë drejtuar në formë të shkruar Komunës me qëllim të përfshirjes në buxhetin e vitit 2019, mirëpo tani nuk di se deri ku ka shkuar realizimi i atyre kërkesave. Edhe në këtë vit besoj se ai ekip ka paraparë kërkesat dhe nëse veç nuk janë dorëzuar ende besoj se do të dorëzohen në Komunë, në mënyrë zyrtare – të shkruar, me qëllim të intervenimit apo edhe përfshirjes së tyre në planifikimet buxhetore të viti 2020.

Kjo formë dhe mënyrë e paraqitjes së kërkesave është sugjeruar para disa viteve edhe nga OSBE që të veprohet kështu, dhe ne vazhdimisht kemi bërë një gjë të tillë, gjithashtu edhe nga Komitetit për Komunitete është kërkuar vazhdimisht një gjë e tillë, mënyrë kjo e cila pajtohemi të gjithë se është zyrtare dhe procedurale, e jo të kërkohet aty për aty ose të kërkohet në një formë lëmosh nga Komuna, por të ketë planifikime buxhetore.

Në lagjen e cekur është intervenuar në disa rrugë sipas projektit që ka qenë, 2 rrugë janë rregulluar me kubëza, kanë mbete edhe 3 rrugë të cilat pritet të rregullohen, pastaj është ndërtuar fusha sportive për nevojat e lagjes, si dhe parku mjaftë i bukur, vend në të cilin është eliminuar hedhja dhe grumbullimi i mbeturinave etj etj.

Si komunitet jemi të kënaqur me shërbimet e komunës në lagjen e cekur, qoftë me intervenime, qoftë me realizim të projekteve infrastrukturore dhe realizime kërkesave të tjera.

Sa i përket rasteve sociale, pa dallime se a janë perona nga komuniteti shumicë apo jo shumicë, duhet të punohet më shumë që t'iu ndihmojmë sepse vërtetë gjendja ekonomike – sociale nuk është e mirë për disa.

**z.Faik Muçiqi**, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, tek rastet sociale, neve si Drejtori pothuajse për çdo ditë ka raste ku na kërkohet intervenim në infrastrukturë, dhe intervenojmë, fjala është për intervenime dhe shërbime të cila nuk kanë ndonjë kosto të lartë dhe që Komuna ka kontraktorë, andaj sërish e them që mos hezitoni që për raste të tilla të na njoftoni sepse nuk ka nevojë të pritët planifikim i buxhetit për raste të intervenimeve të tilla.

Po ashtu edhe nga vizitat që keni nëpër lokalitete ku jetojnë banorë të komunitetit jo shumicë, mos ngurroni të kërkoni ndonjë zyrtar të DSHPMSH për shoqërim, me qëllim që ta shohim gjendjen nga afër.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, në mbledhjen e kaluar anëtarja e Komitetit znj.Doruntina Hasani ka thënë diçka mjaft të qëlluar, fjala është për sigurimin e teksteve shkollore për nxënës të Komunitetit jo shumicë të cilët vijnë shkollimin e mesëm, andaj është mirë që Kryesuesja e Komitetit bashkërisht me ZKKK, dhe me të tjerët, të përgatit një listë të të gjithë atyre nxënësve që iu nevojiten tekstet shkollore sepse vitin e kaluar paksa jua kemi vonuar për shkak të procedurave të prokurimit, andaj në këtë vite është mirë të bëhen të gjitha përgatitjet me kohë dhe me fillim të vitit të ri shkollor t'iu shpërndahen tekstet që Drejtoria e Arsimit jua siguron.

Pra paraprakisht është mirë të kemi një listë të nxënësve dhe t'ia dërgojmë Drejtorisë së Arsimit. Ne jemi në dijeni se MASHT i siguron tekstet shkollore për nxënës të shkollave fillore, por ne si Komunë vazhdimisht ju kemi siguruar edhe nxënësve të komunitetit jo shumicë duke përfshirë edhe disa të komunitetit shumicë që janë në gjendje të rëndë ekonomike – sociale, pra për të mos pasë vonesa në procedura është mirë të përgatitet një listë dhe të procedohet sa më shpejt me qëllim që me fillimin e vitit të ri shkollorë të jemi të gatshëm.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 11:35'**

**Procesverbalin e mbajti  
Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-0062574/19  
Podujevë,  
02 gusht 2019**

**Kryesuese e Komitetit  
Albina Avdiu**

---